

## Material Edukues mbi Instrumentet Financiare (Fx, CFD, Stocks)

### Permbajtja

|  |    |
|--|----|
| Tregu i Kembimit te Valutave (Forex) .....                       | 3  |
| Investuesit e Forex tregtojne cifte monedhash.....               | 3  |
| Cfare i leviz ciftet e monedhave .....                           | 3  |
| Atehere Cfare prisni? .....                                      | 4  |
| Filloni .....  | 4  |
| Monedhat vijne ne cifte.....                                     | 4  |
| Ciftet Kryesore te Monedhave .....                               | 5  |
| Ciftet Ekzotike te Monedhave.....                                | 5  |
| Kryqet e Monedhave Currency Crosses .....                        | 6  |
| Tregtimi i cifteve te monedhave .....                            | 6  |
| Te Blesh nje Cift Monedhash.....                                 | 7  |
| Shitja e nje Cifti Monedhash .....                               | 8  |
| Te mos "Besh" gje me Ciftin e Monedhave.....                     | 9  |
| Menyrat e Tregtimit te Monedhave .....                           | 9  |
| Leva Financiare.....   | 9  |
| Marxhin-i .....  | 9  |
| Hapja/Diferenca/Spread.....                                      | 10 |
| Bazat i Bejne Ciftet e monedhave te levizin .....                | 10 |
| Jo te gjithë indikatorët ekonomik janë te rendesishem.....       | 11 |
| Normat e interesit: Treguesi ekonomik me i rendesishem .....     | 11 |
| Inflacioni ndikon ne normat e interesit.....                     | 12 |
| Menaxhimi i parave.....  | 13 |
| Jeto per te tregtuar nje dite tjeter .....                       | 14 |
| Mesoni Cfare jeni te gatshem te rrezikoni.....                   | 14 |
| Balanca Llogarise / perqindje rreziku = Vleren e Rrezikuar ..... | 15 |
| Percaktimi i vleres se tregtimit.....                            | 15 |
| Urdherat Stop-Loss (stop-humbje) .....                           | 15 |
| Forca ekonomike rrit vleren e monedhes.....                      | 16 |
| Prodhimi kombetar bruto (GDP).....                               | 17 |
| Punesimi Rregullt(jo-ferme) .....                                | 17 |
| Porosite per mallra te qendrueshem .....                         | 17 |
| The Stock and CFD Markets-treGU i STOQEEVE DHE CFD.....          | 18 |

|  |    |
|--|----|
| Tregu i Stoqeve .....  | 18 |
| Perse Cmimi i Stokut Rritet dhe Ulet .....                         | 18 |
| Cfare eshte nje CFD?.....  | 19 |
| Perse Vlera e CFD-ve Ngrihet dhe Ulet .....                        | 19 |
| Efekti i Leves Financiare ne Tregun e CFD-ve .....                 | 19 |
| Atehere Cfare Prisni?.....   | 19 |
| Percaktimi i Vleres se Aksionit .....                              | 20 |
| Kerkesa-Oferta ne tregune aksioneve dhe cfd-ve .....               | 20 |
| Si Rritja e Kerkeses Ndikon ne Vleren e Aksioneve dhe CFD-ve ..... | 21 |
| Si Ndikon Rritja e Ofertes ne Vleren e Aksioneve dhe CFD-ve .....  | 22 |
| Si Ndikon Ulja e Ofertes ne Vleren e Aksioneve ose CFD-ve .....    | 23 |
| Pjestaret e tregut te aksioneve dhe CFD-ve.....                    | 24 |
| Faktore qe ndikojne Ne cmimet e aksioneve .....                    | 25 |
| Fitimet Dhe Tregues te Tjere Te Rendesishem .....                  | 26 |
| Dividentet .....   | 26 |
| Lajme Ekonomike.....   | 26 |
| Levizje te Pergjithshme ne Treg-Fuqia e Sektorit .....             | 28 |

### Tregu i Kembimit te Valutave (Forex)

Tregu i kembimit te monedhave eshte tregu me i madh financiar ne bote. Nje vlere prej rreth \$3.2 trilion tregtohen cdo dite ne treg. FOREX do te thote shkembim valuator—kembimi financiar mbi te cilin shtetet, bankat, korporatat nderkombetare, fondet hedge, dhe investuesit individual kembejne monedha te huaja.

Ata prej jush qe udhetojne jashte shtetit shpesh, ndoshta kane vene re qe kurset e kembimit neper kioskat e aeroporteteve jane gjithnje ne levizje. Disa here ju merrni me shume kur kembeni monedhen tuaj, dhe here te tjera ju duhet te kembeni me shume nga monedha juaj per te marre te njejten vlere. Kjo ndodh sepse kurset e kembimit jane ne levizje te vazhdueshme, dhe jane pikerisht keto ndryshime qe krijojne mundesine per fituar ne tregun e Forex.

### Investuesit e Forex tregtojne cifte monedhash

Cdo gje eshte relative ne tregun Forex. Euro ne vetvete nuk eshte as i forte dhe as i dobet. E njejta gje eshte e vertete edhe per dollarin U.S. Ne vetvete nuk eshte as i forte dhe as i dobet. Vetem kur i krahasoni te dy monedhat me njera tjetren ju mund te shikoni sa e forte ose e dobet sejcila monedhe eshte ne raport me monedhen tjetere.

Monedhat tregtohen gjithmone ne cift. Asnjehere ju nuk bleni thjesht euro ose thjesht shisni dollar US. Ju i tregtoni keto si cift. Disa nga ciftet me te mira te monedhave jane:

|         |                               |
|---------|-------------------------------|
| EUR/USD | (Euro / U.S. dollar)          |
| GBP/USD | (British pound / U.S. dollar) |
| USD/JPY | (U.S. dollar / Japanese yen)  |

Investues si ju, fitojne para cdo dite duke tregtuar cifte monedhash. Duke analizuar se cfare mund ti ndodhi nje cifti monedhash ne te ardhmen, investuesit vendosin se cmund te bejne per te perfituar nga levizjet e cmimit.

Ciftet e monedhave mund te bejne nje nga tre gjerat e meposhtme.

|  |   |
|--|---|
|  | <ul style="list-style-type: none"><li>- Mund te rriten</li><li>- Mund te ulen</li><li>- Mund te shkojne drejt</li></ul> |
|--|---|

Nese ju mund te parashikoni drejtimin e levizjes se ciftit te monedhave, ju mund te gjeneroni goxha te ardhura.

### Cfare i leviz ciftet e monedhave

Clesi i gjenerimit te te ardhurave ne forex eshte te kuptosh se fare I ben keto cifte te levizin. Ne fund jane investuesit ata qe me shit/blerjet e tyre bejne qe te levizin keto cifte. Por keta investues blejne dhe shesin per nje arsye. Ata ose shikojne dicka qe po ndodh ne ekonomine globale qe i ben te mendojne se nje monedhe do te behet me e forte ose qe ajo monedhe do te dobesohet. Me fjale te tjera, ata shikojne gjerat baze dhe marrin vendime bazuar ne ate cka shikojne.

Bazat bejne qe ciftet e monedhave te levizin. Nese bazat e ekonomise ne Shtetet e Bashkuara jane ne permiresim, dollari amerikan (USD) me shume gjasa do te forcohet sepse investuesit ne forex do fillojne blejne dollare. Ne te kundert, nese bazat e ekonomise ne Shtetet e Bashkuara jane duke u perkeqesuar dollari amerikan (USD) me shume gjasa do te dobsohet sepse investuesit ne forex do fillojne shesin dollare.

### Atehere Cfare prisni?

Mijera investitor si ju, po perfitojne nga potenciali i te ardhurave nga tregu i forex. Kur te kuptoni se cfare e ve ne levizje tregun e forex-it, juve ju mbetet vetem te hapni nje llogari tregtimi, te beni analizen tuaj dhe te shtypni disa butona ne postin tuaj te tregtimit online. Dhe me pas uluni, dhe monitoroni tregtite tuaja. Mund tju duhet pak praktike si fillim, por ne nje kohe te shkurter ju do filloni te gjeneroni te ardhura si nje profesionist i vertete. Filloni ti beni parate tuaja te punojne per ju.

### Filloni

Tashme ju i dini avantazhet e tregtimit te forex, dhe mezi prisni te filloni te tregtoni. Tani ju duhet te mesoni perse valle ekziston i gjithë ky treg. Si funksionon? Cfare shkakton levizjen e cifteve te monedhave poshte e lart? Dhe me e rendesishmja, si mund te gjeneroni te ardhura duke tregtuar forex?

Cdo investues i suksesshem ne forex fillon me nje baze te forte njohurish te cilat duhen zgjeruar me tutje. Le tja fillojme me ciftet e monedhave--te cilat jane baza e tregut te forex--dhe si, ju do ti perdorni keto ne tregtimet tuaja.

Ne pjesen e pare, do tu shpjegojme se cfare ju duhet per te kryer tregtimin e pare dhe ne vecanti:

- Cfare eshte nje cift monedhash
- Si mund te tregtoni nje cift monedhash
- Cfare ndodh kur ju tregtoni nje cift monedhash

### Monedhat vijne ne cifte

Cdo gje eshte relative ne tregun Forex. Euro ne vetvete nuk eshte as i forte dhe as i dobet. E njejta gje eshte e vertete edhe per dollarin U.S. Ne vetvete nuk eshte as i forte dhe as i dobet. Vetem kur i krahasoni te dy monedhat me njera tjetren ju mund te shikoni sa e forte ose e dobet sejcila monedhe eshte ne raport me monedhen tjetere.

For example, the euro could be getting stronger compared to the U.S. dollar. However, the euro could also be getting weaker compared to the British pound at the same time.

Monedhat tregtohen gjithmone ne cift. Asnjehere ju nuk bleni thjesht euro ose thjesht shisni dollar US. Ju i tregtoni keto si cift. Nese ju besoni se euro po forcohet krahasuar me dollarin U.S, ju blini euro dhe shisni dollar U.S ne te njejten kohe. Nese ju besoni se dollari U.S po forcohet krahasuar me euron, ju blini dollar U.S dhe shisni euro ne te njejten kohe. Ju gjithmone blini monedhen me te forte dhe shisni ate me te dobtën.

Monedhat ndahen ne 3 grupe kryesore:

- Cifte kryesore
- Cifte ekzotike
- Kombinime

### Ciftet Kryesore te Monedhave

Shumica e investuesve te forex-it fillojne pune duke investuar ne ciftet kryesore te monedhave, ose shkurt kryesoret. Kryesoret jane ato cifte monedhash qe perbehen nga monedhat me te rendesishme ne tregjet boterore—dollari amerikan (USD)—i kryqezuar me shtate monedha te tjera te rendesishme ne bote—euro (EUR), paundi Britanik (GBP), franga Szicerane (CHF), dollari Kanadez (CAD), dollari Australian (AUD) dhe dollari Zelandez (NZD).

Shpenzoni pak kohe per te mesuar se sit e ndiqni ciftet kryesore sepse me gjasa do ti perdorni shume:

|         |                                    |
|---------|------------------------------------|
| EUR/USD | (Euro / U.S. dollar)               |
| GBP/USD | (British pound / U.S. dollar)      |
| USD/CHF | (U.S. dollar / Swiss franc)        |
| USD/JPY | (U.S. dollar / Japanese yen)       |
| USD/CAD | (U.S. dollar / Canadian dollar)    |
| AUD/USD | (Australian dollar / U.S. dollar)  |
| NZD/USD | (New Zealand dollar / U.S. dollar) |

### Ciftet Ekzotike te Monedhave

Ciftet ekzotike te monedhave, ose ekzotiket, jane cifte monedhash qe perbehen nga monedha me e rendesishme ne tregun boteror—dollari Amerikan (USD)—kryqezuar me cdo monedhe tjeter qe nuk hyn tek ato kryesoret. Monedhat ekzotike—si krona Suedeze (SEK), randi i Afrikes se Jugut (ZAR), ose peso Meksikane (MXN)—quhen ekzotike sepse lidhen me monedha jo-likuide qe mund te mos jene ofruara ne nje llogari standarte tregtimi.

Monedhat ekzotike zakonisht tregtohen pak dhe kane diference shit/blerje te madhe. Megjithate, shume nga keto monedha te quajtura “ekzotike” po behen gjithmone e me teper popullore dhe gjithmone e me teper investues po merren me tregtine e tyre.

Ver.1.0

Veshtroni listen e cifteve ekzotike sepse mund te jeni te interesuar ne diversifikimin e portofolit tuaj te forex-it me disa nga keto cifte:

|         |                                    |
|---------|------------------------------------|
| USD/SEK | (U.S. dollar / Swedish krone)      |
| USD/NOK | (U.S. dollar / Norwegian krone)    |
| USD/DKK | (U.S. dollar / Danish krone)       |
| USD/HKD | (U.S. dollar / Hong Kong dollar)   |
| USD/ZAR | (U.S. dollar / South African rand) |
| USD/THB | (U.S. dollar / Thai baht)          |
| USD/SGD | (U.S. dollar / Singapore dollar)   |
| USD/MXN | (U.S. dollar / Mexican peso)       |

#### Kryqet e Monedhave Currency Crosses

Kryqet e monedhave, ose thjesht kryqet, jane cifte monedhash te berbera nga cdo dy lloj monedhash—persa kohe qe asnjera prej tyre nuk eshte dollar American (USD). Euro (EUR) ciftuar me poundin Britanik (GBP) ose dollari Australian (AUD) me jenin Japonez (JPY) mund te konsiderohen kryqe monedhash.

Me poshte jane listuar disa nga kryqet me te perdorura te monedhave:

|         |                                    |
|---------|------------------------------------|
| GBP/JPY | (British pound / Japanese yen)     |
| EUR/GBP | (Euro / British pound)             |
| AUD/JPY | (Australian dollar / Japanese yen) |
| EUR/CAD | (Euro / Canadian dollar)           |
| CAD/JPY | (Canadian dollar / Japanese yen)   |

#### Tregtimi i cifteve te monedhave

Investuesit gjenerojne te ardhura cdo dite duke tregtuar monedha. Duke parashikuar se cmund te ndodhi me nje cift monedhash ne te ardhmen, investuesit mund te vendosin se si mund te perfitojne nga levizjet e ardhshme te cmimeve.

Ciftet e monedhave mund te bejne nje nga tre gjerat e meposhtme:

- Mund te ngrihen
- Mund te ulen
- Mund te mos ndryshoje

Perpara se te vendosni nese nje cift monedhash do te ngrihet, ulet apo te qendroje pa ndryshuar, ju duhet te identifikoni monedhen ne cift qe po forcohet apo ate qe po dobeshet ne krahasim me tjetren. Per shembull nese shikoni ciftin EUR/USD (euro/dollar Amerikan), ju duhet te identifikoni nese euro po forcohet kunder dollarit Amerika nose e kunderta.

**Shenim:** Monedha e pare e listuar ne cift quhet monedha *baze* ndersa tjetra quhet '*monedha e kuotuar*'. Cmimi i nje cifti monedhash tregon se sa monedha te kuotuar duhen per te blere nje njesi nga monedha baze.

Nese monedha baze eshte duke u forcuar kundrejt asaj te kuotuar, cifti i monedhave do te ngrihet. Nese monedha e kuotuar po forcohet kundrejt monedhes baze, atehere cifti i monedhave do te ulet. Nese monedha baze dhe ajo e kuotuar jane njesoj te forta, atehere cifti i monedhave do qendroje konstant.

Me poshte eshte paraqitur nje reference e shpejte per tju ndihmuar ne cilen ane cifti i monedhave do te levizi:

- Baza > e Kuotuar = Lart
- Baza < e Kuotuar = Poshte
- Baza = te Kuotuar = Konstante


Kur te vendosni se ne cilen ane besoni se cifti i monedhave do te levizi, atehere vendosni urdhrin tuaj. Kur tregtoni forex, ju mund te beni nje nga keto tre gjera:

- Ju mund te blini ciftin e monedhave
- Ju mund te shisni ciftin e monedhave
- Te mos beni gje

#### Te Blesh nje Cift Monedhash

Ju mund te gjeneroni te ardhura duke tregtuar forex nese *bleni* nje cift monedhash kur monedha baze eshte duke u forcuar krahasuar me monedhen e kuotuar.

**Te Hysh ne Tregtim**—Blerja e nje cifti monedhash eshte aq e thjeshte sa te klikosh butonin "Buy" ne platformen tuaj.



Nderkohe qe ju duhet thjesht te klikoni vetem nje buton, eshte shume e rendesishme te dini se cfare ndodh prapa. Megjithate, mos u shqetesoni per teknikalitetet tani per tani. Do te mesoni cfare ndodh prapa skenave kur te mesoni tregtimin me *marzhin*.


**Te Mbyllesh Pozicionin**—Blerja e cifti monedhash eshte vetem hapi i pare ne procesin e tregtimit. Per te mbyllur/kopletuar tregtine dhe per te marre fitimin, ose humbjen, juve ju duhet te dilni/mbyllni tregtine e bere. Per te mbyllur tregtimin, ju thjesht duhet te beni te kunderten e veprimit qe bete kur hapet tregtimin. Nese blete nje cift monedhash kur hapet tregtimin, ju duhet te shisni te njejtin cift per te mbyllur tregtine.

Per shembull, nese bleni EUR/USD per te hyre ne nje tregtim, duhet te shisni EUR/USD per te mbyllur kete tregtim.

#### Shitja e nje Cifti Monedhash

Ju mund te gjeneroni fitime duke tregtuar monedha. Nese *shisni* nje cift monedhash kur monedha e dyte ne cift (monedha e kuotuar) eshte duke u forcuar krahasuar me te paren (monedha baze).

**Hapja e nje Pozicioni**—Shitja e nje cifti monedhash kryhet vetem duke shtypur butonin “Sell” (Shitje) ne platformen tuaj.



Ndersa ju vecse duhet te shtypni nje buton, njohja se cfare ndodh pas ketij veprimi eshte shume e rendesishme. Megjithate, nuk eshte e nevojshme te shqetesoheni per teknikalitetet tani. Do te mesoni se cfare ndodh prapa skenave kur te mesoni rreth tregtimit me *marxhin*.

**Exiting the trade Mbyllja e Tregtimit**—Shitja e cifti monedhash eshte vetem hapi i pare ne procesin e tregtimit. Per te mbyllur/kopletuar tregtine dhe per te marre fitimin, ose humbjen, juve ju duhet te dilni/mbyllni tregtine e bere. Per te mbyllur tregtimin, ju thjesht duhet te beni te kunderten e veprimit qe bete kur hapet tregtimin. Nese blete nje cift monedhash kur hapet tregtimin, ju duhet te shisni te njejtin cift per te mbyllur tregtine.



### Te mos "Besh" gje me Ciftin e Monedhave

Nuk mund te gjeneroni fitime duke tregtuar cifte monedhash nese monedha e pare ne cift (monedha baze) nuk eshte duke u forcuar/dobesuar kundrejt monedhes se dyte (monedha e kuotuar). Kur vleara e ciftit te monedhave mbetet kostonnte eshte shume e veshtire te gjenerohen fitime me shit/blerjen e ciftit te monedhave.

Per te gjeneruar fitime kur cifti i monedhave qendron pergjithesisht konstant, ju duhet te perdorni *opsionet* e forex. Do te mesoni me teper rreth *opsioneve* te forex-it—me vone gjate studimeve rreth forex-it. Tani per tani, perqendrohuni se si te identifikoni kur nje cift monedhash po forcohet/dobesohet dhe se si te perfitoni nga keto levizje.

### Menyrat e Tregtimit te Monedhave

Tregu i monedhadhe eshte shume i ngjashem me tregjet e tjera me te cilat ju ndoshta keni hasur ne jeten e perditshme—psh ne supermarket ose ne tregun e makinave—ku ju mund te blini ose shisni sende per nje vlere te caktuar. Megjithate, ne tregun e monedhave ju gezoni disa avantazhe. Per shembull, kur tregtoni forex me BKT Smart Invest, ju mund te kontrolloni dhe perfitoni nga sasi te medha monedhash pa qene nevoja te paguani te gjithe shumen qe ne fillim.

Per te vleresuar dhe perdoruar ne maksimum avantazhet qe ju ofron investimi ne tregun e forex, ju duhet te kuptoni se si funksionon cdo tregtim qe ju ndermerrni. Ne vecanti, duhet te kuptoni 3(tre) konceptet e meposhtme:

- Leva financiare
- Marxhin
- Diference Shit/Blerje

### Leva Financiare

Leva financiare eshte ndoshta karakteristika qe i intrigon me shume investoret individual. Leva eshte aftesia per te konvertuar nje force te vogel ne nje force te madhe duke perdorur nje vegjel. Imagjinoni sikur ju duhet te levizni nje gur te madh nga pozicioni aktual. Sigurisht qe mund te provonit ta leviznit me duar por do ta kishit me te lehte nese do te perdornit nje vegjel- le te themi nje cope dru te gjate—dhe ta vendosnit posht gurit gje qe do tu jepte efektin leve.

I njejti princip eshte i vlefshem edhe kur investoni ne tregun e forex-it. Ju mund te fitoi para duke investuar parate tuaja, por mund te fitoni akoma me shume para duke perdorur efektin e leves financiare duke huazuar para nga ndermjetesi/dealer-i juaj.

Keshtu, ju mund te perdorni leven, ose me mire te themi, te rrisni fuqine tuaj te investimit ne forex duke perdorur pak nga fondet tuaja dhe pjesen tjeter ta huazoni nga dealer-i. Per shembull, tregu forex-it te lejon te kontrolloni rreth \$100,000 me vetem \$1,000 tuajat. Kjo do te thote qe ju duhet te pagoni vetem **1 perqind** te pozicionit nga fondet tuaja dhe pjesa tjeter prej 99 perqind do te paguhet nga dealer-i juaj.

Leva financiare ne tregun e forex-it percaktohet nga vlere e marxhin-it qe ju duhet te paguani per cdo tregtim.

### Marxhin-i

Tregu i forex-it eshte i vecante sepse dealer-i juaj eshte i gatshem tju japi fonde hua ne menyre qe ju te keni mundesine qe te rrisni potencialin tuaj te fitimit ne te gjitha tregtimet tuaja. Megjithate, perpara se dealer-i tju japi fonde hua, ju duhet te tregoni se keni mjaftueshem fonde per te mbuluar cdo humbje qe mund te pesoni. Marxhini, jane fondet qe ju vendosni menjane tek dealer-i juaj si prove qe jeni ne gjendje te mbulloni humbjet qe mund te keni.

Per shembull, nese blini EUR/USD, ju do tu duhet te vendosni menjane 1% te madhesis se pozicionit si marxhin. Kjo do te thote qe, nese madhesia e pozicionit eshte 100,000 euro, juve do tu duhet te ndani menjane rreth 1000 euro per ti provuar dealer-it tuaj qe mund ti mbuloni humbjet e te pakten 1000 eurove nese tregtia merr per keq.

Cifte te ndryshme monedhash kane kerkesa per marxhin te ndryshme. Ciftet kryesore te monedhave kane kerkesa per marxhin te vogla per shkak te niveleve te larta te liquiditetit gje qe ben hapjen dhe mbylljen e nje tregtimi shume te shpejte duke ulur keshtu mundesine e humbjeve te papritura. Ciftet ekzotike te monedhave duke patur likuiditet te ulet e bejne me te veshtire hapjen dhe mbylljen e tregtime shpejt keshtu qe dhe vlerat marxhineve jane me te larta.

Shume tregtar te rinj ne forex gabojne ne mendimin qe fondet e ndara menjane si marxhin shkojne per blerjen e monedhave. Kjo nuk eshte e vertete. E verteta eshte qe ju huazoni 100 perqind te vleres se blerjes se monedhave nga dealer-i. Marxhini juaj thjesht i tregon dealer-it tuaj qe ju keni fonde te mjaftueshme qe te mbuloni cdo humbje qe mund te keni.

Kur ju blini nje cift monedhash, nuk ju kerkohet te paguani nga fondet tuaja paraprakisht. Brokleri juaj ju jep hua fonde te mjaftueshme per te blere vleren e kerkuar te monedhes tjeter ne cift. Per shembull nese klikoni ne butonin **Blej/Buy** per te blere 100,000 EUR/USD cifte, dealer-i juaj do tju japi mjaftueshem hua ne dollar (USD) per te blere 100,000 euro. Nese kursi EUR/USD ne ate cast eshte 1.4000, dealer-i juaj do tju japi hua deri ne 140,000 dollare (USD) per te blere 100,000 euro.

#### Hapja/Diferenca/Spread

**Hapja/Diferenca/Spread** eshte distanca ndermjet cmimit qe ju blini nje cift monedhash dhe cmimit qe ju shisni kete cift monedhash ne ate cast.

Ju smund te blini nje cift monedhash dhe menjehere ta shisni ate me nje cmim me te ulet. Cmimi me te cilin ju blini nje cift monedhash (**Ask/Blerje**), eshte gjithmone me i larte se cmimi me te cilin e mund ta shisni (**Bid/Shitje**).

Kurdohere qe hyni ne nje tregtim, ju filloni me nje humbje te vogel per shkak te spread-it. Ju duhet ta kaloni kete diference/spread—ta mbani pozicionin per aq kohe sa duhet—perpara se te filloni te krijoni fitim nga tregtimi. Eshte nje pengese e vogel per tu kaluar dhe nje cmim i vogel per tu paguar kundrejt avantazhit te leves financiare dhe liquiditetit qe BKT Smart Invest ofron ne tregun e forex-it

#### Bazat i Bejne Ciftet e monedhave te levizin

Cilesi i te berit para ne Forex eshte te kuptuarit se cfare e ben nje cift monedhash te levize. Ne fund, jane investoret ata qe i bejne ciftet e monedhave te levizin duke blere dhe shitur monedha te ndryshme. Por investoret blejne dhe shesin per nje arsye. Ose shikojne dicka qe po ndryshon ne ekonomine boterore qe i ben te besojne qe nje monedhe do te forcohet ose dobesohet. Me fjale te tjera, ata shikojne bazat dhe marrin vendimet e tyre ne baze te asaj cka shikojne.

Bazat bejne ciftet e monedhave te levizin. Nese bazat ekonomike ne Shtetet e Bashkuara jane duke u permiresuar, dollari (USD) me shume gjasa do te forcohet sepse investuesit do te blejne dollare. Ne te kundert, nese bazat ekonomike ne Shtetet e Bashkuara jane duke u perkeqesuar, atehere me shume gjasa USD do te dobesohet sepse investuesit do te shesin dollare.

Ju duhet te mesoni te studioni treguesit ekonomik baze qe bejne te levizin ciftet e monedha ashtu sikunder dhe investoret profesional bejne. Ne kete sesion, do tju shpjegojme sa me poshte per tju ndihmuar te keni nje ide sa me te qarte:

|            |  |
|------------|--|
| Permbajtja | Cilet tregues ekonomik jane me te rendesishem      |
|            | Perse normat e interesave jane kaq te rendesishme  |
|            | Cfare ndikimi ka inflacioni tek normat e interest. |

### Jo te gjithë indikatorët ekonomik janë të rëndësishëm

Globalizimi na ka afruar të gjithë në pranë njëri-tjetrit dhe ka vënë në dispozicionin tonë miliona njësi informacioni në ditë. Pjesë e të qenit një investues Forex-i i suksesshem është të mesosh se si të injorosh shumicën e lajmeve dhe informacionit që na bombardon çdo ditë dhe të fokusohesh në informacionin e rëndësishëm.

Jo të gjithë indikatorët ekonomik janë të rëndësishëm. Ju do të shikoni shumë lajmerime ekonomike baze që nuk duhet tu kushtoni shumë vëmendje. Për shembull, papunesia në Irlandë nuk është aq e rëndësishme sa papunesia në Shtetet e Bashkuara. Por ndërsa papunesia në Irlandë është e rëndësishme, ekonomia amerikane ka një ndikim shumë më të madh në ekonomine botërore kështu që investuesit i kushtojnë më tepër rëndësi lajmeve ekonomike nga Shtetet e Bashkuara.

Mos harroni, në fund të fundit janë investuesit e mëdhenj institucional që levizin tregun e Forex-it, kështu që ju duhet të mesoni të shikoni të njëjtat gjëra që ata shikojnë. Duke bërë kështu ju mund të parashikoni më saktësisht çfarë levizjesh ata do të bëjnë që të krijoni një avantazh për veten tuaj nga ato levizje.

|          |  |
|----------|--|
| Shembull | Një rrugë shumë e mirë që të krijoni një avantazh në çmim është të shikoni lajmet. Ju do të mesoni se si të fitoni nga lajmet e paparashikuara kur të mbaroni me sesionin e Analizës së Lajmeve. |
|----------|--|

Treguesit thelbësor më të rëndësishëm ekonomik mund të ndahen në këto tre grupe:

|   |                        |
|---|------------------------|
| - | Normat e interesit     |
| - | Fuqia ekonomike        |
| - | Capital and trade flow |

Do të mesoni më shumë rreth forcës ekonomike, kapitalit dhe treguesve tregtar në seksionet e tjera. Në këto seksione ju do të mesoni rreth normave të interesit—treguesi ekonomik baze më i rëndësishëm në tregun e Forex-it.

### Normat e interesit: Treguesi ekonomik më i rëndësishëm

Normat e interesit rregullojnë tregun e Forex-it. Monedhat që përfaqësojnë ekonomite me norma interesi të larta janë më të forta se monedhat që përfaqësojnë ekonomite me norma të ulëta interesi. Investuesit

gjithmone kerkojne fitimin me te madh te mundshem nga investimet e tyre, dhe ekonomite me interesa me te larta zakonisht kane me teper fitim ne investime.

Imagjinoni sikur po ecni ne rruge dhe po kerkoni nje vend ku te depozitoni parate dhe shikoni dy banka. Banka ne te djathte ju ofron 6% interes per parate qe depozitoni. Banka ne te majte po ju ofron vetem 2% interes per parate tuaja. Sigurisht, ju do ti depozitoni parate ne banken qe ofron 6% interes mbi parate tuaja sepse ju kerkoni me teper nga investimi juaj.

I njejti princip i aplikohet cdo ekonomie dhe monedhave te tyre respective. Nese ju mund te merrni 6% fitim mbi investimin tuaj ne Mbreterine e Bashkuar, por vetem 2% ne Zvicer, ka shume mundesi qe ju do te investoni ne Mbreterine e Bashkuar.

Keshtu pra, si ndikon kjo ne vleren e Paundit Britanik (GBP)?

Megjese tashme gjithnje e me shume njerez investojne parate e tyre ne Mbreterine e Bashkuar, kerkesa per pound (GBP) rritet. Bazat e ekonomise na tregojne qe nese kerkesa rritet, vlera e paundit Britanik (GBP) do te rritet gjithashtu.

Investuesit e sukseshem gjithmone vezhgojne Bankat Kombetare (organizmat qe vendosin normat e interesit) per te kuptuar mundesine e ndryshimit te normave te interesit prej tyre, norma interesi me te ulta ose lenia e normave te interesit te pandryshueshme.

Bankat qendrore me te rendesishme jane:

- United States—Federal Reserve (The Fed)
- European Union—European Central Bank (ECB)
- United Kingdom—Bank of England (BOE)
- Japan—Bank of Japan (BOJ)
- Switzerland—Swiss National Bank (SNB)
- Canada—Bank of Canada (BOC)
- Australia—Reserve Bank of Australia (RBA)
- New Zealand—Reserve Bank of New Zealand (RBNZ)

### Inflacioni ndikon ne normat e interesit

Investuesit e sukseshem gjithmone vezhgojne bankat qendrore per te kuptuar se cfare keto te fundit do te bejne me normat e interesit. Investuesit e sukseshem gjithashtu vezhgojne treguesit ekonomik qe bankat qendrore kane parasysh kur marrin vendimet e tyre per ndryshimin e normave te interesit.

Nje tregues ekonomik shume i rendesishem qe bankat qendrore kane parasysh kur marrin vendimet lidhur me normen e interesit eshte *inflacioni*. **Inflacioni** eshte rritja e pergjithshme e cmimit te te mirave dhe sherbimeve. Per shembull, me shume mundesi ju sot paguani me teper per 1-liter qumesht apo nje buke, me cfare paguanit per to 10-20 vjet me perpara. Po ashtu mund te keni degjuar te moshuarit te komentojne se sa e shtrenjte cdo gje eshte bere sot. Te gjitha ne perballemi me inflacionin.

Inflacioni i moderuar pergjithesisht pranohet si nje efekt anesor/mbetje natyrale i rritjes ekonomike. Megjithate, inflacioni i larte mund ta demtojte ekonomine.

Bankat qendrore jane gjithmone te kujdesshme ndaj inflacionit. Kur shikojne qe inflacioni po rritet ne nivele te papershtatshme, ato bejne c'eshte e mundur per te frenuar kete rritje. Nje mjet qe bankat

qendrore perdorin per te ulur inflacionin eshte norma e interesit—bankat qendrore luftojne rritjen e inflacionit nuke rritur normen e interesit.

Normat e larta te interesit e bejne me te veshtire per bizneset dhe individet marrjen e kredive per te blere dhe ndertuar gjera te reja cka sjell ngadalesimin e rritjes ekonomike dhe si rezultat, inflacion.

## Shembull

Inflacioni ishte I tmerrshem ne Gjermani pas Luftes Pare Boterore.Paqendrushermeria ekonomike shkaktoi nje zhvleresim dramatik te Markes Gjermane.Mund te krijoni nje ide se sa keq ishte situatet vetem duke pare cmimin e pullave postare Gjermane.Ne Prill 1921,kushtonte rreth 0.60 marka per te postuar nje leter nga nje qytet ne tjetrin.Megjithate,ne Dhjetor 1923,vetem 15 muaj mbrapa—kushtonte rreth 100,000,000,000 marka per te postuar te njejten leter.Megjithese ky eshte nje shembull extrem, kjo tregon se inflacioni do te jete gjithmone pjese e jeteve tona.

Si nje investues ne Forex, ju duhet te kontrolloni vazhdimisht normen e inflacionit per te patur nje ide se cfare vendimi bankat qendrore mund te marrin rreth normave te interesit. Nese inflacioni eshte ne rritje, bankat qendrore me shume mundesi do te rrisin normat e interesit, cfare eshte gje e mire per monedhen e atij vendi. Ju, gjithashtu duhet te shikoni me vemendje 2(dy) treguesit e meposhtem te inflacionit per te patur nje ide se cfare bankat qendrore shikojne/vleresojne:

**Indeksi i Cmimit te Konsumit (ICK):** Eshte treguesi ekonomik qe mat koston e ushqime te shportes qe konsumatori blen rregullisht. Sa me shume para ti duhen konsumatorit per gjerat bazike, aq me pak para do ti mbeten per gjera te tjera jo-bazike.

**Indeksi i Cmimit te Prodhimit (ICP)-Producer's Price Index (PPI):** Eshte treguesi ekonomik qe mat sa shume prodhuesit duhet te paguajne per materiale baze qe perdorin ne produktet e tyre perfundimtare.Nese cmimet per materialet baze rriten, atehere me shume mundesi prodhuesit do tua kalojne koston shtese konsumatoreve.

## Menaxhimi i parave

Pjesa me e rendesishme e investimit eshte menaxhimi i parase. Menaxhimi i parase perfshin percaktimit e pjeses se portofolit qe ju jeni te gatshen te rrezikoni ne cdo tregtim. Menaxhimi i kujdesshem i parase mund te beje diferencen midis nje llogarije te suksesshme qe ju mund ta menaxhoni gjate ne te ardhmen dhe nje llogarie jo te suksesshme qe do boshatiset brenda 6 muajve.

Nese keni pare ndonje turne pokeri ne televizor,atehere keni pare menaxhimin e parese ne kohe reale.Rralle do te shikoni nje lojtare qe do luaj te gjitha cipset ne nje dore te vetme.Ne shumicen e rasteve do te ishte budallallek ta beje nje gje te tille.Nese lojtari do te rrezikonte vetem nje pjese te portofolit ne nje loje, fito ose humb,atehere ai do te kishte fonde per lojen tjetere.Por nese lojtari rrezikon gjithcka vetem ne nje loje, e vetmja menyre per te vazhduar me tej eshte fitorja e kesaj loje. Kjo eshte goxha peshe mbi lojtarin dhe ai duhet te kete letra me te vertete shume te mira per te justifikuar nje levizje te tille te guximshme.

Investuesit me te suksesshem jane ata qe kane percaktuar rregulla te rrepta qe rregullojne tregtite e tyre. Keto rregulla i ndihmojne tu shmangen kurtheve te menaxhimit te fondeve qe mesuat deri tani dhe ti mbajne emocionet nen kontroll. Te listuar me poshte jane 3 rregulla te menaxhimit te fondeve qe mund ti aplikoni ne tregtimet tuaja.

|            |  |
|------------|--|
| Permbajtja | Jeto per te tregtuar nje dite tjeter   |
|            | Percakto se cfare/sa mund te rrezikoni |
|            | Meso te percaktoni vleren e tregtimit  |

Gjithashtu do te mesoni dhe nje nga mjetet me te rendesishme te tregut te Forex-it: *stop loss/stop humbje*.

#### Jeto per te tregtuar nje dite tjeter

*Jeto per te tregtuar nje dite tjeter*, eshte ndoshta keshilla me e mire qe mund te merrni si investues. Pavaresisht faktit qe analiza juaj mund te jete gabim ose e drejte, nese jetoni per te tregtuar je dite tjeter, ju do te keni nje shans tjeter per te fituar para. Dy rregullat me poshte do tju tregojne ekzaktesisht se cfare duhet te beni qe te mbijetoni cdo dite ne tregun e Forex-it. Per sa kohe ju kuptoni dhe besoni rregullin e pare, do te keni nje avantazh paraprak mbi shumicen e investuesve.

Shkaktari kryesor qe ben qe shumica e investuesve te lodhin veten dhe te humbin parate ne llogarite e tyre eshte *lakmia*. Kur investuesit behen lakmitar, marrin risqe te panevojshme. Ata gjithashtu shpenzojne ore te panumerta duke u munduar te gjejne indikatorin ose lajmin ekonomik qe eshte "Grali i Shenjte" i investimit. Ata besojne qe nese ndjekin ate indikator special apo ate cfare lajmi ekonomik thote, gjithmone do te kene nje tregtim fitimprures—ata do te kene gjithmone te drejte. Disa i referohen si *salca sekrete* e investimit.

Fatkeqesisht, e gjithë kjo shprese dhe kerkim eshte jo-produktive thjesht sepse nuk ekziston nje *salca sekrete*. Sigurisht, mund te gjendet ndonje indikator qe funksionon per nje peridudhe te caktuar ne historine e tregut, por tregu ndryshon dhe shume shpejt nje indikator tjeter do te behet i preferuari i rradhes. Ose mund te degjojne nje lajm qe e kane ndjekur per disa muaj dhe besojne se kane gjetur celesin e suksesit ne investim. Por, perseri, tregu do te ndryshoje dhe ata do te kerkojne nje celes te ri drejt suksesit. Per te shmangur zhgenjimin qe vjen gjithmone si pasoje e ndjekjes se *bishtit tend*, do tju tregojme se si te jetoni per te tregtuar nje dite tjeter ne menyre qe sido qe te ndryshoje tregu jut e jeni te suksesshem.

#### Mesoni Cfare jeni te gatshem te rrezikoni

*Mesoni cfare jeni te gatshem te rrezikoni* perpara se te hyni ne nje tregtim. Ky rregull eshte parimi baze i te jetuarit per te tregtuar nje dite tjeter. Nese nuk rrezikoni shume nga llogaria juaj ne nje tregtim sot, do te keni mjaftueshen ne llogarine tuaj per te nesermen—edhe nese humbisni ne tregti sot—per te bere tregti te nesermen. Me fjale te tjera, nuk eshte e keshillueshme vendosja e te gjitha parave ne *nje* apo *dy* pozicione tregtimi. Meqe ju kurre nuk do te dine se cfare do ti ndodhi tregut, asnjehere nuk duhet te rrezikoni gjithcka vetem ne *nje* pozicion.

Gjeja e pare qe duhet te percaktoni eshte se sa perqind te llogarise jeni te gatshem te humbisni ne nje tregtim. Kur ta keni vendosur kete, pjesa tjeter eshte thjesht matematike e thjeshte. Shumica e investuesve ndjehen rehat duke rrezikuar rreth 2% te shumes totale te llogarise ne nje tregtim. Ky eshte vetem nje rregull i pergjithshem, nderkohe qe ju duhet te percaktoni sa agresive ose conservative doni te jeni me llogarine tuaj. Nese doni te jeni me agresive, do tu duhet te rrezikoni nje perqindje me te larte te llogarise tuaj ne nje tregtim. Nese doni te jeni me konservative, do tu duhet te rrezikoni nje vlere me te vogel te llogarise ne nje tregtim. Ju e vendosni se sa jeni te gatshem te rrezikoni, por duhet te dini nje gje—shmangni te dy ekstremet. Nese doni te jeni me agresive, konsideroni te rrezikoni midis 2 dhe 5 perqind ne cdo tregtim. Nese doni te jeni me conservative, konsideroni te rrezikoni midis 1 dhe

2 perqind ne cdo tregtim. Nese rrezikoni me shume, me shume mundesi nuk do te keni shans te tregtoni dite tjeter per shume kohe. Nese rrezikoni shume pak, me siguri qe nuk do te fitoni shume nga tregtimi.

Pasi te keni percaktuar perqindjen e vleres se llogarise tuaj qe jeni ne gjendje te rrezikoni, gjithcka mbetet eshte qe te ate numer ne ekuacionin e meposhtem:

**Balanca Llogarise / perqindje rreziku = Vleren e Rrezikuar**

Ja nje shembull se si kjo do te funksionoje. Imagjinoni sikur keni nje llogari prej \$50,000 dhe ju keni deshire te rrezikoni deri ne 2% te llogarise per cdo tregtim. Nese fusni numrat ne ekuacionin e meposhtem, do te shikoni qe ju nuk duhet te rrezikoni me shume se \$1,000 ne cdo tregtim.

$$\$50,000 / 0.02 = \$1,000$$

Pe tu mbajtur mend eshte se ky eshte maximum qe mund te rrezikoni ne nje tregtim. Ju mund te keni me shume se kaq ne rrezik ne llogarine tuaj nese keni disa pozicione te hapura. Nese do te kishit tre pozicione te hapura, atehere do te rrezikonit ne total \$3,000. Kur te percaktoni shumen qe jeni ne gjendje te rrezikoni, atehere jeni gati te percaktoni vleren e tregtimit.

**Percaktimi i vleres se tregtimit**

*Percaktimi i vleres se tregtimit* behet per te parandaluar ekspozim te panevojshem ndaj riskut. Vlera e tregtimit/pozicionit eshte vlera qe bleni/shisni ne nje tregtim. Kur dini sa doni te rrezikoni, atehere do tu duhet mesoni se si te vendosni tregtimet ne menyre qe ne fund mos te rrezikoni me teper nga sa doni. Nuk sjell dobi qe te njihni tolerance ndaj rrezikut dhe nderkohe te hyni ne nje tregti qe e ekspozon shume llogarine tuaj ndaj tij.

Per te percaktuar vleren e tregtimit, ne fillim duhet te percaktoni ku te vendosni *stop-loss (stop-humbje)*, ju duhet te dini sa pips gjenden ndermjet pikes ku hyni ne tregtim dhe pikes qe keni percaktuar si stop-loss. Tani nuk ju mbetet vecse te fusni ate vlere ne nje ekuacion te thjeshte qe bazohet mbi ate me siper.

Te dini se si te percaktoni madhesine/vleren e tregtimit do tu ndihmoje te eliminoni nje nga armiqt me te keqij te tregtarit: friken. Tregtaret qe nuk percaktojne madhesine e tregtimit jane gjate gjithe kohes te shqetesuar se mos humbin nga llogaria e tyre me shume se sa duan te rrezikojne. Nese eliminoni friken nga tregtia, do te jeni ne gjendje te merrni vendime me te mira.

$$\text{Vlera e rrezikuar} \div (\text{pips te rrezikuar} - \text{vlera per pip}) = \text{madhesine e tregtimit}$$

**Urdherat Stop-Loss (stop-humbje)**

Nje urdher stop-loss-i eshte nje urdher qe ju vendosni per te mbyllur tregtimin nese cifti monedhave arrin nje cmim te caktuar. Urdherat stop-loss ju lejojne te mbron llogarine edhe gjate kohes qe nuk jeni perballe kompjuterit cka eshte e rendesishme sepse fizikisht eshte e pamundur te shikoni tregtimet 24 ore ne dite

Nese *bleni* nje cift monedhash, do tu duhet te vendosni nje stop-loss diku poshte cmimit aktual per tju mbrojtur ne rastin kur cmimi i ciftit te monedhave leviz ne anen e kundert. Por nese *shisni* nje cift monedhash, do tu duhet te vendosni nje stop-loss diku me lart se cmimi aktual per tju mbrojtur ne rast se cmimi i ciftit te monedhave leviz ne ane te kundert.

Ja si funksionon:

Imagjinoni sikur ju bleni EUR/USD me 1.4000. Nderkohe ju vini re se ekziston nje suport i forte diku rreth 50 pips poshte cmimit aktual, ne 1.3950. Pas analizes se bere, ju arrini ne konkluzionin qe, nese EUR/USD zbret poshte ketij niveli me shume mundesi do te vazhdoje te zbrese me poshte. Meqe ju blete, do te humbisni para nese cmimi leviz per poshte. Keshtu qe, ju vendosni qe do ta mbyllni pozicionin/tregtimin nese EUR/USD zbret poshte 1.3950. Per te mbrojtur llogarine tuaj, ju vendosni nje stop-loss ne 1.3940 qe do te mbylli pozicionin nese cmimi prek kete nivel. Diten dhe naten, nese cmimi prek kete nivel pozicioni do te mbyllet automatikisht per ju. Urdherat *stop-loss* japin siguri gjate tregtimit dhe luajne nje rol kritik ne te gjitha vendimet e menaxhimit te parase. Asnjehere mos hapni nje tregtim/pozicion pa vendosur nje te tille.

#### Forca ekonomike rrit vleren e monedhes

Ekonomite e forta zakonisht kane monedha te forta. Te dyja keto ecin bashke. Kur nje ekonomi performon mire, do te thote qe korporatat jane duke gjeneruar fitime, dhe ne shumicen e rasteve normat e interesave rriten. Sejcila prej ketyre karakteristikave te nje ekonomie te forte eshte ne avantazhin tuaj si tregtar Forex-i.

Ju e mbani mend nga seksioni mbi analizen baze, qe rritja e normave te interesit eshte treguesi me i parashikueshem per rritjen e vleres te monedhave, dhe bankat qendrore percaktojne normat e interesave kur inflacioni i matur sipas indeksit te konsumatorit (CPI) dhe atij te prodhimit (PPI), fillon te rritet me shpejtesi.

Rritja ekonomike shtyn inflacionin lart. Ja si funksionon. Sa me e forte ekonomia, aq me e larte behet kerkesa per fuqi punetore. Ndersa kerkesa per fuqi punetore rritet aq me shume rriten pagat e tyre. Sa me shume para qe punonjesit fitojne aq me shume do te shpenzojne per te blere produkte dhe sherbime. Ndersa kerkesa per keto produkte dhe sherbime rritet, cmimi per keto gjera gjithashtu rritet- me fjale te tjera edhe inflacioni.

Natyrisht, nese bankat qendrore mbajne nen vezhgim treguesit e inflacionit (si CPI dhe PPI) gjate procesit te vendim marrjes, ju mund te gjykoni se ata do te jene gjithashtu te interesuar per te mbajtur nen vezhgim edhe treguesit e forces ekonomike—dhe sigurisht qe ata e bejne nje gje te tille

Bankat qendrore shikojne treguesit ekonomike te meposhtem per percaktimin e forces ekonomike dhe ju duhet te beni te njejten gje:

|            |                                    |
|------------|------------------------------------|
| Permbajtja | Prodhimi kombetar bruto (GDP)      |
|            | Punesimi Jo-Ferme (i rregullt)     |
|            | Porosite per mallra te qendrueshem |
|            | Shitjet                            |



### Prodhimi kombetar bruto (GDP)

GDP eshte matesi me i gjere ne dispozicion i aktivitetit ekonomik. I raportuar cdo tre mujor, GDP-ja ndiqet shume si treguesi kryesor i fortesise ekonomike.

GDP-ja pasqyron vleren totale te prodhimit te nje vendi, dhe konsiston ne blerjet e produkteve dhe shebimeve te prodhuara ne vend nga individe, biznese, te huaj dhe qeveria.

Meqe raportet e GDP shpesh jane subjekt te ndryshimeve substanciale, preferohet te ndiqet treguesi i GDP-se vit pas viti. Mund te jete e vlefshme te ndiqet drejtimi i rritjes ne sejcilin prej kategorive te GDP-se per te percaktuar pikat e forta dhe te forta te ekonomise.

Shpesh nje shifer e larte e GDP-se lidhet me pritshmeri te normave te interesit ne rritje, gje qe shpesh eshte positive, te pakten per nje periudhe te shkurter per monedhen ne fjale. Kjo pervec rasteve kur forca e inflacionit ne rritje demton besimin ndaj monedhes.

### Punesimi Rregullt(jo-ferme)

Punesimi i rregullt eshte nje tregues i numrit te njerezve qe paguhen si punonjes nga nje kompani jo-ferme dhe sektore te tjere te qeverise. Ndryshimet mujore ne punesimin e rregullt reflektojne numrin neto te vendeve te reja te punes te krijuara apo te humbura gjate muajit dhe keto ndryshime ndiqen shume si nje tregues i rendesishem i aktivitetit ekonomik.

Punesimi i rregullt eshte nje nga treguesit primar te aktivitetit ekonomik sepse permbledh cdo sektor kryesor te ekonomise. Gjithashtu eshte i dobishem ne percaktimin e trendeve ne krijimin e vendeve te punes ne shume lloje te industrive sepse te dhenat e mbledhura mund te maskojne devijime te medha te trendeve ne industri.

Rritje te medha te punesimit shikohen si shenje te nje aktiviteti te forte ekonomik qe mund te coje ne rritje te normave te interesit qe suportojne monedhen te pakten per nje periudhe te shkurter. Megjithate, nese trysnia e rritjes se inflacionit shikohet si ne rritje, kjo mund te minoje besimin afatgjate tek monedha.

### Porosite per mallra te qendrueshem

Porosite per mallrat e qendrueshem jane treguesi i urdherave te rinj ndaj prodhuesve vendas per levrime te menjehershme apo te ardhshem nga magazinat per mallra te tille. Perqindjet e ndryshimeve mujore reflektojne normen e ndryshimit te ketyre urdherave.

Nivelet dhe ndryshimet e porosive per mallra qe qendrueshem ndiqen gjeresisht si tregues te rendesishem te momentumit te sektorit te prodhimit.

Porosite per mallrat e qendrueshem jane nje tregues i rendesishem per te indentifikuar drejtimin e sektorit te prodhimit. Kjo sepse, shumica e prodhimit industrial behet sipas porosive. Shume here, treguesi ndiqet por perjashton porosite ushtarake dhe ato te transportit sepse keto zakonisht jane shume volatile ne krahasim me porosite e tjera dhe mund te maskojne disi drejtimin e treguesit.

Porosite per mallra te qendrueshem maten ne terma nominal keshtu qe perfshijne edhe efektet e inflacionit. Pra, porosite per mallrat e qendrueshem duhet te krahasohen me drejtimin e normes se rritjes ne PPI per te arritur ne treguesin e vertete te Porosive te Urdherave te Qendrueshem te rregulluar sipas inflacionit

Rritja e porosive per mallrat e qendrueshem zakonisht shoqerohet me rritje te aktivitetit ekonomik dhe si rrjedhoje mund te sjelli rritje te normave afat-shkurtra te interesit dhe pergjithesisht suportojne monedhen, te pakten per nje kohe te shkurter.

Shitjet me pakice jane nje mase e totalit te faturave te bera nga dyqanet. Perqindja e ndryshimeve mujore reflekton normen e ndryshimit te ketyre shitjeve qe ndiqen shume si nje tregues i shpenzimeve te konsumatorit.

Shitjet me pakice jane nje tregues themelor i shpenzimeve te konsumatorit sepse keto bejne rreth gjysmen e totalit te shpenzimeve te konsumatorit dhe afersisht nje te terten te aktivitetit ekonomik.

Shpesh, shitjet me pakice ndiqen me pak persa i perket shitjeve te makinave sepse keto jane shume volatile se sa pjesa tjeter e shitjeve me pakice dhe keshtu qe mund te mbulojne drejtimin/trendin me te rendesishem.

### The Stock and CFD Markets-treGU i STOQEVE DHE CFD

Asnjehere me pare tregu global financiar nuk ka qene kaq virant dhe I gjalle, dhe asnjehere me pare nuk ka qene kaq afer jush si nje investitor individual. Ju jeni ne nje pozicion te vecante. Asnje here me pare investitoret individual kane patur akses ne cfare kane deshiruar nga tregjet boterore financiare. Tashme ju mundeni.

Tregjet e stoqeve dhe CFD-ve ju japin investitoreve akses ne tregjet boterore te tregut me nje fleksibilitet te larte.

Le te shohim bazat e funksionimit te sejcilit treg. Po fillojme me tregun e stoqeve dhe me pas do vazhdojme me ate te CFD-ve.

### Tregu i Stoqeve

Investuesit tregtojne stoqe—aksione ten je kompanie—ndermjet tregjeve te kembimit. Para ngritjes se internetit, tregjet e kembimit zyra fizike ku investuesit ose ndermjetesit e tyre, mblidheshin bashke dhe shikonin se cmund te blini nose shisnin. I tille eshte dhe sot New York Stock Exchange (NYSE) dhe London Stock Exchange (LSE). Por me ardhjen e internetit, filloi dhe hyrja e tregjeve te kembimit te bazuar ne Internet si NASDAQ. Pavaresisht nese transaksionet ndodhin ne nje zyre ose ne web, kryesorja per ju si investitor eshte ekzistenca e nje vendi ku mund te shisni dhe blini stoqet tuaja.

Perse do te donit te blini dhe shisni stoqe ndersa thjesht mund ti blinit dhe ti mbanit? Investitoret blejne dhe shesin stoqe ne baze te bindjes se tyre se si cmimi i tyre do te ndryshoje ne te ardhmen.

### Perse Cmimi i Stokut Rritet dhe Ulet

Kompanite jane ne biznes per te fituar. Ju nuk duhet ti komplikoni gjerat me tutje. Kompanite duan te krijojne fitime. Kur kompanite krijojne fitime, manageret ose i ri-investojne parate ne kompani per rritje te metejshme, ose ja u shperndajne keto para pronareve te biznesit. Sic sapo mesuat, ju blini nje pjese te kompanise kur blini stokun e saj, qe do te thote qe menaxheret po ja u shperndajne parate juve. Keto shperndarje parash tek zoteruesit e stoqeve quhen dividend.

Kompanite qe vazhdojne rritjen gjenerojne gjithnje e me shume te ardhura keshtu qe cmimi i stoqeve te tyre rritet gjithmone e me shume. Cmimet e stoqet te kompanive qe nuk rriten dhe nuk gjenerojne shume e me shume te ardhura tentojne te shkojne gjithnje e me ulet. Megjithate, nje investitor stoqesh thjesht nuk mund te shikoje se si stoku qe po performon sot, kur eshte ne procesin e vendim marrjes se cilin stock te shesi apo te blej. Investitoret jane me shume te interesuar se si kompania do te sillet nesor, muajin tjeter ose vitin e ardhshem. Nese ata besojne se kompania do te rritet dhe do vazhdoje te gjeneroje te ardhura, ata do te blejne stoqe. Ndersa, ata besojne se kompania nuk do te vazhdoje te rritet dh te gjeneroje te ardhura si ne te shkuaren, ata do te shesin stoqe.

Tashme ju keni nje informacion bazik mbi tregun e stoqeve, keshtu tani le ti hedhim nje sy tregut te CFD-ve.

### Cfare eshte nje CFD?

Nje CFD eshte nje kontrate per diference, eshte nje kontrate qe rritet ose bie ne vlere ne varesi te vleres se stokut mbi te cilin bazohet.

### Perse Vlera e CFD-ve Ngrihet dhe Ulet

Nje CFD shton ose humb vlere nderkohe qe *diferenca* midis cmimit te stokut kur ju blete CFD-ne, dhe cmimit actual te stokut ndryshon. P.sh nese ju blini nje CFD te bazuar ne stokun e Microsoft (MSFT), dhe vlera e ketij stoku ulet, atehere edhe vlera e CFD-se bazuar ne kete stok do te ulet. Dhe e kunderta, nese vlera e stokut do te rritet edhe vlera e CFD-se bazuar ne kete stok do te rritet.

### Efekti i Leves Financiare ne Tregun e CFD-ve

Megjese vlera e CFD eshte e lidhur me vleren e stokut ku bazohet, atehere perse most te tregtojme vetem stok? Perse do te donit te tregonit edhe CFD? Pergjigjja eshte: Efekti Leve Financiare. Kur ju tregtoni CFD, ju mund te perdorni efektin e leves financiare per rritur te ardhurat e investimit tuaj.

Kur ju blini nje stok, ju duhet te paguani cmimin e plote te stokut. Nese stoku tregtohet me \$25, ju duhet te paguani \$25 per te. Nese tregtohet me \$100, ju duhet te paguani \$100. Kur ju blini nje CFD, ju duhet te paguani vetem nje pjese te cmimit total te stokut—ne disa raste vetem 5 perqind.

Leva financiare shton fitimet, por gjithashtu mund te shtoje dhe humbjet. Imagjinoni rastin sikur ju blini nje CFD bazuar mbi nje stok qe tregtohet per \$50, por ju, duhet te keni menjane vetem \$5 per CFD-ne, pasi ju po perfitoni nga efekti i leves financiare dhe mund te paguani vetem 10% te vleres se ketij stoku. Tani, imagjinoni sikur vlera e stokut rritet me 10%, nga \$50 ne \$55. Si ndikon kjo ne tregtimin e CFD-se tuaj? Kujtoni qe, CFD eshte nje kontrate per *diference*, keshtu qe diferenca eshte:  $\$55 - \$50 = \$5$ . Nese do te kishit blere stokun do kishit bere 10% fitim ( $\$5 \div \$50 = 10\%$ ). Meqe ju blete nje CFD dhe shpenzuat vetem \$5 per te bere nje tregtim ju bete:  $\$5 \div \$5 = 100\%$ .

Nderkohe qe ky eshte nje fitim i madh, mos harroni qe leva financiare mund te punoje edhe kundra jush. Nese ju do te kishit hyre ne te njejtin transakcion me CFD dhe vlera e stokut do te ishte ulur me \$5, nga \$50 ne \$45, ju do te kishit humbur gjithashtu nje pjese te madhe te investimit tuaj. Nese ju do te kishit blere kete stok, ju do te kishit pesuar nje humbje prej 10%: ( $-\$5 \div \$50 = -10\%$ ). Nderkohe, kur blete CFD-ne, ju kishit vetem \$5 menjane per tregtimin, ndersa tashme ju do te kishit humbur 100% te investimit tuaj ( $-\$5 \div \$5 = -100\%$ ).

Leva financiare eshte nje mjet i jashtezakonshem. Perdoreni ate me kujdes.

### Atehere Cfare Prisni?

Mijera investitor si ju, po perfitojne nga potenciali i te ardhurave nga tregu I stoqeve dhe i CFD-ve. Konceptet bazike jane te thjeshta per tu kuptuar—kur kompanite performojne mire, cmimi i stokut te tyre ngrihet, dhe kur ato nuk performojne mire, cmimi i stokut te tyre ulet. Krahas stoqeve, CFD-te ju ofrojne fleksibilitet te larte juve si investues individual. Kur kuptoni se cfare e ve ne levizje tregun e stoqeve, juve ju mbetet vecse te hapni nje llogari tregtimi, te beni analizen tuaj dhe te shtypni disa butona ne postin tuaj te tregtimit online. Uluni, dhe monitoroni tregtite tuaja. Mund tju duhet pak praktike si fillim, por ne nje kohe te shkurter ju do filloni te gjeneroni te ardhura si nje profesionist i vertete. Filloni ti beni parate tuaja te punojne per ju.

### Percaktimi i Vleres se Aksionit

Cmimi i aksioneve leviz poshte dhe larte vazhdimisht. Eshte kjo levizje qe motivon njerezit te tregtojne aksione dhe CFD.fundja, nese cmimi I aksioneve nuk do te levizte ateherë asnjëri nuk do te fitonte para nga tregtia e aksioneve dhe CFD-ve, keshtu qe ju nuk do te ishit ketu.

Pyetja eshte cfare e shkakton cmimin e aksioneve te levize poshte e lart? Perse nje aksion ka nje cmim nje moment dhe nje moment tjeter ka nje cmim tjeter? Pergjigja eshte se ka shume arsye qe cmimi i aksioneve leviz. Kjo mund te vije si pasoje e lajmeve mbi fitimin e kompanise, renia ekonomike etj. Por cdo gje varet nga forca e kerkeses dhe ofertes. Per te qene i suksesshem ju duhet ti kushtoni rendesi tablose kryesore dhe jo te fokusoheni vetem ne nje ose dy faktore.


Per tju ndihmuar te kuptoni pse cmimi I aksioneve leviz poshte e larte ne vlere, do te shikojme:

|            |   |
|------------|---|
| Permbajtja | Forca e kerkeses dhe ofertes  |
|            | Kush merr pjese ne tregun e aksioneve dhe CFD-ve                              |
|            | Cfare faktoresh tregtaret shikojne kur vleresojne (i vene cmimin) nje aksioni |

### Kerkesa-Oferta ne tregune aksioneve dhe cfd-ve

Cmimi i aksionit dhe CFD-se leviz si pasoje e kerkeses dhe ofertes. Oferta leviz si pasoje e numrit te aksioneve ose CFD-ve qe i ofrohen publikut investues. Kerkesa levzs sipas deshires se tregtareve per te blere ose per te shitur aksionin ose CFD-ne ne fjale.

Ketu mund te shikoni grafik tipik te kerkeses-ofertes. Kerkesa eshte paraqitur me vijen qe shkon per poshte nga e majta ne te djathte, ndersa oferta eshte paraqitur me vijen qe shkon per lart nga e djathta ne te majte. Pika ku keto dy vija takohen eshte cmimi qe tregu do te pranoje per aksionin ose CFD-ne.




Te dy keto, kerkesa dhe oferta mund rriten ose te ulen si pasoje e kushteve te ndryshme ne treg. Do te shikojme se si faktoret me poshte ndikojne ne vleren e aksioneve ose CFD-ve:

|   |                   |
|---|-------------------|
| - | Rritja e kerkeses |
| - | Rritja e ofertes  |
| - | Renia e kerkeses  |
| - | Renia e ofertes   |

**Si Rritja e Kerkeses Ndikon ne Vleren e Aksioneve dhe CFD-ve**

Rritja e kerkeses per nje aksion ose CFD rrit vleren e atij aksioni ose CFD-je.

Duke pare grafikun e kerkese-ofertes ne te djathte ju mund te shikoni qe ndersa kerkesa rritet, vija e kerkeses leviz me djathtas. Ndersa leviz ne te djathte, pika ku vija e kerkeses takon ate te ofertes leviz lart e me lart. Kjo tregon se me rritjen e kerkeses per nje aksion ose CFD, vlera e atij aksioni ose CFD-je rritet.




Kerkesa per nje aksion ose CFD mund te rritet kur kompanite lajmerojne per fitime tre mujore ose vjetore me te mira sec pritej. Per shembull, kur Apple Inc. (AAPL: xnas) lajmeroi per rritjen e fitimeve qe kompania kishte arritur fale shitjeve te medha te ipod-it, tregtaret filluan te blinin aksione te kompanise me shprese qe kompania do te vazhdonte te kishte fitime kolosale.

#### Si Ndikon Rritja e Ofertes ne Vleren e Aksioneve dhe CFD-ve

Rritja e ofertes te nje aksioni ose CFD-je e ul vleren e atij aksioni ose CFD-je.

Duke pare grafikun e kerkese-ofertes ne te djathte ju mund te shikoni qe ndersa oferta rritet, vija e ofertes leviz ne te djath te grafikut. Ndersa leviz ne te djathte, pika ku vija e kerkeses takon ate te ofertes leviz poshte. Kjo tregon se duke rritur oferten e nje aksioni apo CFD-je ul vleren e atij aksioni apo CFD-je.




Oferta e nje aksioni ose CFD-je mund te rritet kur nje index madh vendos te heqe nje akson nga lista e tij. Per shembull, Honeywell (HON: xnys), nje prodhues industrial, ishte dikur pjese e indeksit industrial te Dow Jones-it. Kur kushtet ekonomike ndryshuan dhe e bene Honeywell-in me pak te rendesishem per Dow Jones-in, ky i fundit vendosi ta heqe ate nga indeksi. Si pasoje e ketij ndryshimi, shume menaxher fondesh investimesh qe administronin portfolet e tyre bazuar ne indeksin e Dow Jones, i shiten aksionet e Honeywell-it duke rritur keshtu oferten e ketyre aksioneve per shitje ne treg.

#### Si Ndikon Ulja e Ofertes ne Vleren e Aksioneve ose CFD-ve

Ulja e kerkeses per nje aksion ose CFD ul vleren e atij aksioni ose CFD-je.

Duke pare grafikun e kerkese-ofertes me poshte ju mund te shikoni qe ndersa kerkesa ulet, vija ekerkeses leviz ne te majte te grafikut. Ndersa leviz ne te majte, pika ku vija e kerkeses takon vijen e ofertes leviz per poshte. Kjo tregon qe ulja e kerkeses per nje aksion ose CFD ul vleren e atij aksioni apo CFD-je.



Kerkesa per nje aksion apo CFD mund te ulet kur tregtaret marri lajme ose thashetheme te jo te mira rreth nje kompanie. Per shembull, prodhuesi boteror farmaceutik Merck & Co. (MRK: xnys) u detyrua ne 2004 te terhiqte ilacin e famshem te artritit Vioxx, per shkak te raporteve qe ky ilac rriste shanset e sulmeve ne zemer per pacientet qe e perdornin. Sic mund ta imagjinoni, tregtaret ishin te shqetesuar se humja e fitimeve nga shitja e Vioxx s dhe mundesia e humbjeve te tjera per shkak te padive do te ndikonte tek fitimet e Merck-ut. Si pasoje e kesaj kerkesese aksionet e Merck-ut u zbehen.

Oferta per nje aksion ose CFD mund te ulet ndersa kompanite blejne mbrapsht aksionet e tyre. Kompanite me fonde te teperta qe besojne se aksionet e tyre po tregtohen me cmim te ulet, shpesh do ti blejne mbrapsht aksionet e tyre ne menyre qe te rrisin vleren e aksioneve per te investuar me shume ne kompani.

Tani qe kuptoni se si ndryshimet ne kerkesese dhe oferte mund te ndikojne ne cmimin e aksioneve apo CFD-ve, duhet te kuptoni edhe se cfare shakton keto ndryshime ne kerkesese dhe oferte. Ose, me mire te themi, kush shkakton ato ndryshime.

#### [Pjestaret e tregut te aksioneve dhe CFD-ve](#)

Tregu i aksioneve dhe CFD-ve bashkon njez dhe grupe te ndryshme ne ne nje vend per te bere tregti dhe cdonjeri prej tyre ndikon ne forcat e kerkesese-ofertes. Megjithate, ndersa keta njez dhe grupe te ndryshme bashkohen ne te njejtin vend per tregti, cdonjeri prej tyre eshte teresisht i ndryshem nga tjetri. Cdo pjestar i tregut ka agenden e tij dhe disa nevoja te percaktuara per tu konsideruar gjate tregtimit. Disa pjestare duan te mbarojne pune shpejt, ndersa te tjere duan te blejne dhe ti mbajne aksionet apo CFD-te per periudha te gjata. Disa pjestare kane sasi shume te medha fondesh qe duan ti investojne ndersa te tjere kane sasi te vogla fondesh ne llogari personale. Te kuptuarit e nevojave dhe objektivave te pjesmarresve te ndryshem ne treg ju ndihmon ne te kuptuarit me mire te asaj se cfare po ndodh ne treg. Kjo ju vendos ne nje pozicion me te mire per te perfituar nga levizjet e cmimit.



Per ilustrim do ti ndajme pjestaret me te medhej te tregut ne dy grupe kryesore:

|   |                         |
|---|-------------------------|
| - | Investues Institucional |
| - | Investues Individual    |

**Investuesit Institucional** Keta jane investues te medhej professional qe kontrollojne sasi kolosale parash. Ky grup zakonisht merret me fonde te perbashketa investimesh, fonde hedge, fonde pensionesh etj. Meqe jane kaq te medhej dhe me influence, keta jane ata tek te cilet ju duhet te fokusoheni per te vendosur se si kerkese-oferta do te ndryshoje ne te ardhmen.

**Investues Individual** Keta jane njerez si ju qe ndoshta tregtojne aksione apo CFD per te siguruar jetesen, ose ndoshta thjesht per te patur te ardhura shtese. Ky grup nuk duhet te ndikojte gjykimin tuaj.

Investuesit Institucional jane ata qe levizin tregjet. Sepse kane aq shume para nen menaxhim sa qe kane mundesi te levizin cmimin lart ose poshte kur vendosin te blejne ose te shesin aksione. Sic mund ta imagjinoni, nje tregtar qe blen 1,000,000 aksione do ndikojte ne cmim me shume se tjetere qe blen vetem 100 aksione.

Shumica e investuesve institucional operojne nen urdhera te rrepta per te ndjekur disa rregulla dhe investuar vetem ne klasa specifike asetesh. Per shembull disa fonde njihen si fonde te medha te kufizuara. Kjo do te thote se ato mund te blejne aksione vetem ne ato kompani qe kane nje vlere tregu mbi \$5 miliard dollare. Qe do te thote qe mund te blejne aksione vetem ne kompani teknologjike si Microsoft (MSFT: xnas) ose Google (GOOG: xnas).

Duke ditur se cfare investuesit institucional po bejne me portfolet e tyre mund tju ndihmoje te kuptoni si forcat e kerkese-ofertes do te levizin dhe si keto do te ndikojne ne cmimit e aksionit. Sigurisht kjo vetenese punoni aty, ne rastet e tjera ju nuk do ta dini kurre se cfare keta tregtare kane ndermend te bejne. Por nese dini se cfare keta tregtar studiojne kur marrin vendimet e tyre, ju mund te studion te njejtat gjera dhe si rrjedhoje te keni nje tablo te qarte te asaj se cfare duhet te beni.

#### Faktore qe ndikojne Ne cmimet e aksioneve

Many different factors affect share prices. A few key factors tend to play a more important role in determining the value of a share than others. Generally speaking, the following are the four factors that you should watch most closely:

|   |  |
|---|--|
| - | Fitimet dhe te tjera gjera baze                      |
| - | Dividend   |
| - | Lajme Ekonomike                                      |
| - | Ndryshimete pergjithshme ne fuqine e tregut/sectorit |

### Fitimet Dhe Tregues te Tjere Te Rendesishem

Performanca e kompanise eshte nje nga forcat kryesore qe ndikon ne cmimim e aksioneve. Sepse ne fund te fundit, kur ju blini aksione te kompanise ju po blini nje pjese te kompanise gje qe ju jep te drejten te merrni pjese ne sukseset dhe deshtimet e saj. Natyrisht, nese kompania ecen mire, gjithmone e me shume tregtare do te jene te interesuar per te blere aksionet e saj. Kjo gje ne vetvete do te sjelli nje rritje te kerkeses per aksione gje qe zakonisht do te sjelli rritjen e cmimit. Nese kompania nuk ecen mire, gjithmone e me pak tregtare do te jene te interesuar per te blere aksionet e saj, gje qe sjell nje ulje te kerkeses per keto aksione dhe si rrjedhoje nje ulje te cmimit.

Gjate analizes se ecurise se nje kompanise, tregtaret dhe analistet do te marrin ne shqyrtim shume tregues te rendesishem te kompanise (psh. Te dhena nga bilanci dhe pasqyrat finaciare te kompanise). Fitimet e Kompanise- sasia e parave qe nje kompanie i mbetet pasi ka paguar te gjitha shpenzimet e saj-kjo eshte vlera me e rendesishme qe tregtaret zakonisht shikojne. Megjithate, ka dhe tregues te tjere te rendesishem si *kthimi nga kapitali* (ROE) dhe raporti *cmim-vlere kontabel* qe jep nje pasqyre te pergjithshme te shendetit te kompanise. Ju do te mesoni me teper mbi treguesit kryesore te kompanise ne pjeset e tjera.

### Dividentet

Kompanite mund te bejne njeran nga keto dy gjera kur gjenerojne te ardhura: mund ti mbajne dhe ti ri-investojne ne kompani ose mund tjua shperndajne aksionereve ne formen e dividentit. Dividentet jane pagesa ne para ndaj aksionereve bazuar mbi numrin e aksioneve qe ata zoterojne. Per shembull, nese nje kompani me 1,000,000 aksione te ndara do te paguante nje dividend prej £5,000,000 –cdo aksioner do te merrte £5 per aksion.

Tregtaret i vleresojne shume dividentet sepse e dine qe do marrin pagesa te rregullta ne para nga investimet e tyre.Meqenese dividentet jane kaq te cmuar,nje kompani mund te rrisi vleren e aksioneve duke paguar nje dividend me te madh(per sa kohe qe fitimet e kompanise jane ne rritje).Aksionet e kompanive me dividente ne rritje pergjithesisht pesojne rritje vlere, ndersa ato me dividente ne ulje pesojne ulje te vleres se aksioneve .Fatkeqesisht sot,gjithmone e me pak kompani paguajne dividente, duke zgjedhur ti mbajne parate per ti ri-investuar ne kompani.

### Lajme Ekonomike

Lajmet ekonomike jane ato qe jepen nga qeverite dhe grupe te medha qe ndikojne ne teresine ekonomike, jo vetem ne kompani te vecanta. Ketu futen lajmet rreth normave te interesit dhe produktit te brendshem bruto (GDP).

Pjesa me e madhe e lajmeve ekonomike qe do te jene te rendesishme per ju si tregtar aksionesh dhe CFD-sh jane te planifikuara muaj me pare. Per shembull ju do mesoni 1 vit perpara se kur U.S. Federal Open Market Committee (FOMC) do te mblidhet per te diskutuar mbi ndryshimet e normave te interesit. E njejta gje ndodh edhe ne UK ku buxhetet e qeverise dhe mini-buxhetet planifikohen kohe perpara. Kjo ju jep kohe te mjaftueshme per te bere kerkime rreth permbajtjes se lajmeve dhe per te rregulluar pozicionin e portofolit tuaj.

BKT Smart Invest ju siguron kalendarin ekonomik minute pas minute, keshtu qe ju do te jeni gjithmone ne dijeni se cfare lajmi/informacioni do jetepet sot, neser dhe ne te ardhmen.

| Thursday, 29-Nov-2007 |         |                                |        |           |       |
|-----------------------|---------|--------------------------------|--------|-----------|-------|
| Time                  | Country | Event                          | Period | Consensus | Prior |
| 7:00 AM               |         | ILO Unemployment Rate          | OCT    | --        | --    |
| 8:30 AM               |         | GDP s.a. (QoQ)                 | 3Q     | --        | --    |
| 8:30 AM               |         | GDP w.d.a. (YoY)               | 3Q     | --        | --    |
| 8:55 AM               |         | Unemployment Change (000s)     | NOV    | --        | --    |
| 8:55 AM               |         | Unemployment Rate (s.a)        | NOV    | --        | --    |
| 9:00 AM               |         | PPI (MoM)                      | OCT    | --        | --    |
| 9:00 AM               |         | PPI (YoY)                      | OCT    | --        | --    |
| 9:30 AM               |         | M4 Money Supply (MoM)          | OCT F  | --        | --    |
| 9:30 AM               |         | M4 Money Supply (YoY)          | OCT F  | --        | --    |
| 9:30 AM               |         | M4 Sterling Lending (BP)       | OCT F  | --        | --    |
| 12:00 PM              |         | NBNZ Business Confidence       | OCT    | --        | --    |
| 1:30 PM               |         | GDP Price Index                | 2Q P   | --        | --    |
| 1:30 PM               |         | GDP Annualized                 | 3Q P   | --        | --    |
| 1:30 PM               |         | Personal Consumption           | 2Q P   | --        | --    |
| 1:30 PM               |         | Initial Jobless Claims         | 24-Nov | --        | --    |
| 3:00 PM               |         | New Home Sales                 | OCT    | --        | --    |
| 3:00 PM               |         | Help Wanted Index              | OCT    | --        | --    |
| 3:00 PM               |         | New Home Sales MoM             | OCT    | --        | --    |
| 3:30 PM               |         | EIA Natural Gas Storage Change | 23-Nov | --        | --    |
| 3:30 bW               |         | EIA Natural Gas Storage Change | 23-Nov | --        | --    |
| 3:00 bW               |         | MoM sales change               | OCT    | --        | --    |
| 3:00 bW               |         | Help Wanted Index              | OCT    | --        | --    |
| 3:00 bW               |         | sales change                   | OCT    | --        | --    |
| 1:30 bW               |         | initial jobless claims         | 24-Nov | --        | --    |
| 1:30 bW               |         | personal consumption           | 2Q P   | --        | --    |
| 1:30 bW               |         | GDP, annualized                | 3Q P   | --        | --    |

Nje shikim i shpejte kalendarit ekonomik ju jep mundesine te mesoni paraprakisht se cilat jane ngjarjet qe kane potencial per te pershpejtuar levizjen e monedhave. Keto ngjarje mund te permbajne lajme p.sh rreth papunise ne gjermani, GDP ne Shtetet e Bashkuara etj.

Analistet e investimeve, ekonomistet dhe pjestare te tjere te tregut analizojne gjate gjithes kohes lajmet ekonomike, duke u perpjekur keshtu te parashikojne se cili do te jete lajmi i rradhes. Megjithese nuk do te gjen kurre dy analiste me te njejtin konkluzion, ju mund te percaktoni se cila do te jete mesatarja. Kjo mesatare njihet si "consensus estimate" (konsensusi i pergjithshem).

Njohja e ketij konsensusi do tu ndihmoje te perfitoni prej levizjes se cmimit kur lajmi ekonomik te dale, sepse konsensusi mbi cmimin do te jete tashme i inkorporuar ne vleren e CFD-ve qe ju po ndiqni. Ja si funksionon:

Pasi kane finalizuar analizat e tyre, investuesit fillojne duke vendosur urdherat e tregtimit per te perfituar prej ku ata mendojne se cmimi do shkoje ne te ardhmen. Ata nuk presin deri sa lajmi te dali. Ata duan te jene perpara tregut. Keshtu qe, kur lajmi del, shumica e pjestareve ne treg i ka vendosur urdherat e tregtimit tashme.

Nese kur lajmi del, dhe vlera eshte ne linje me ate te konsensusit te pergjithshem cmimet e aksioneve apo CFD-ve nuk do te levizin shume. Kjo sepse shumica e tregtareve te medhej i kane vendosur urdherat e tyre dhe nuk ka tregtare te tjere qe duan te hyjne ne tretime. Por nese numri pas daljes se lajmit eshte me i madh ose me i ulet nga konsensusi i meparshem, cmimi i aksioneve apo i CFD-ve do te shkoje larte ose poshte ne baze te informacionit te ri.

Gjate kesaj kohe, kur pjestaret e tregut nxitojne te reagojne ndaj lajmeve te reja, ju do te keni njeh mundesi te shkelqyer per te perfituar nga levizjet e cmimit.

### Levizje te Pergjithshme ne Treg-Fuqia e Sektorit

Kompanive ju pelqen te mendojne se performance e tyre duhet te jete i vetmi faktor ne levizjen e cmimit te aksioneve te tyre. Fatkeqesisht per to, forca te tjera te pergjithshme ne treg mund te ulin ose te rrisin vleren e aksioneve pavaresisht asaj qe ndodh me kompanite.

Ekziston nje thenie e vjeter qe cdo tregtar aksionesh apo CFD-je duhet ta dije: "*Batica ngre te gjitha anijet*". Kjo do te thote qe, nese jeni ne nje treg bullish (ne rritje) shumica e aksioneve do te jene ne rritje sepse edhe ekonomia pergjigjesisht do te jene ne rritje. Ne anen tjeter, kjo do te thote qe nese jeni ne nje treg bearish (ne renie), shumica e aksioneve do te jene duke u ulur sepse tregu dhe ekonomia ne pergjithesi jane renie ose ne tkurrje.

Ashtu sikunder tregu ne pergjithesi mund te levizi larte ose poshte, disa sektore Brenda tregut mund te levizin larte ose poshte. Per shembull, aksionet ne sektorin e shendetesisive mund te jene duke shkuar lart ndersa ne te njejten kohe ato te sektorit te shitjeve mund te jene duke rrene. Forcat *bullish dhe bearish* ne sektore te vecante mund te kene te njejtin impakt ne aksionet e atyre sektoreve sikunder forcat bullish ose bearish mund te kene ne tregun e pergjithshem.

Do te mesoni si te analizoni drejtimin e tregut dhe sektoreve ne nje document tjeter. Deri ketu thjesht njohja qe keto forca ekzistojne ju vendos perpara shumices se tregtareve te tjere.